



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs*

**Akademia e Kosovës për Siguri Publike**  
**Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost**  
**Kosovo Academy for Public Safety**

**Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë - Divizija za Spoljne Odnose - External Relations Division**

Në bazë të Nenit 6 të Rregullores (AKSP) nr. 01/2021 për mobilitetin, trajnimet, studimet dhe vizitat studimore të studentëve, Divizioni për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ) në bashkëpunim me Fakultetin e Sigurisë Publike (FSP) të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP) shpall këtë

## **N J O F T I M**

Për pjesëmarrjen e 1 (një) studenti të FSP të AKSP në mobilitet krediti përmes programit Erasmus+ për 1 (një) semestër në Fakultetin e Sigurisë në Shkup të Universitetit St. Kliment Ohridski të Manastirit në Maqedoninë e Veriut.

Qëllimi i këtij aktiviteti është që studenti i përzgjedhur nga FSP i AKSP të qëndrojë për një semestër të plotë për arritjen e kredive (ECTS) në Fakultetin e Sigurisë në Shkup të Universitetit St. Kliment Ohridski të Manastirit në Maqedoninë e Veriut, të cilat kredi do të transferohen dhe njihen nga FSP i AKSP. Qëndrimi do të jetë në semestrin dimëror të vitit të ardhshëm akademik 2024/2025, pra nga tetori 2024 deri në janar 2025. Ky mobilitet është në kuadër të Marrëveshjes Ndër-Institucionale të programit Erasmus+ të BE-së të nënshkruar ndërmjet të dyja institucioneve.

Studentët do të përkrahen financiarisht për të gjitha shpenzimet e bërë sipas kriterëve dhe tarifave që zbatohen nga Erasmus+ për mobilitete të këtij lloji.

Kriteret që duhet të plotësohen për studentët që dëshirojnë të aplikojnë janë si në vijim:

- Në vitin akademik 2024/2025 të jetë student-e i/e vitit të tretë të studimeve Bachelor në FSP (kriter nga FSP i AKSP-së i dalë nga analiza e përputhshmërisë së lëndëve ndërmjet të dyja institucioneve);
- Të jetë programi i ngjajshëm apo i përafërt për të cilat aplikojnë me programin Bachelor në FSP (në këtë rast ky kriter plotësohet vetëm nga studentët e Drejtimit Policor);
- Të njohin gjuhën angleze.

1. Në rast se numri i studentëve është më i madh se numri i kërkuar për këtë aktivitet, përparësi kanë studentët sipas kësaj radhe:
  - Student-i/ja që nuk ka qenë pjesë e ndonjë programi për mobilitet apo programi tjetër në ndonjë aktivitet tjetër jashtë shtetit përmes AKSP-së;
  - Student-i/ja që ka notë mesatare më të lartë;
  - Studenti-/ja që ka kontribuar në promovimin e AKSP-së në forma të ndryshme të koordinuara apo organizuara nga AKSP.
  
2. Dokumentet dhe kërkesat e nevojshme të aplikimit për këtë aktivitet janë:
  - Certifikata/transkripta e notave (e cila shkarkohet nga sistemi elektronik SMU);
  - CV (në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës dhe/ose në gjuhën angleze);
  - Kopje e pasaportës;
  - Një letër motivimi (në gjuhën angleze), duke përfshirë të dhënat personale, si: emrin dhe mbiemrin, gjininë, e-mail adresën dhe vitin e studimeve;
  - Vërtetim për student/e (jo më të vjetër se një muaj, i lëshuar nga FSP) që konfirmon nivelin tuaj të studimeve dhe vitin akademik (ky dokument merret në FSP dhe dorëzohet në DMJ pas përzgjedhjes së studentit përkatës) dhe
  - Certifikata e gjuhës angleze (niveli minimal i gjuhës angleze B1).
  
3. Nëse student-i/ja i/e interesuar për aplikim nuk e posedon ndonjë certifikatë të gjuhës angleze, e cila dëshmon që ai/a jo e njëj gjuhën angleze në nivelin B1 sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (anglisht: Common European Framework of Reference for Languages - CEFR), njoftoheni se **të hënën më 3 qershor 2024 nga ora 10:00 - 11:00** në sallën në katin e sipërm të Qendrës Mësimore “Steve Bennett”, profesori i juaj i gjuhës angleze, dr. Halil Asllani, do të organizojë një test me shkrim dhe verbal për këtë qëllim.

Dokumentet e kompletuara siç janë kërkuar në këtë Njoftim duhet t’i dërgoni më së voni deri **të premten më 31 maj 2024 deri në fund të orarit të punës (ora 16:00)** në dy mënyra:

- Përmes e-mailit të Skender Agaj, Zyrtar për marrëdhënie me jashtë në Divizionin për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ) në AKSP në [skender.agaj@rks-gov.net](mailto:skender.agaj@rks-gov.net) dhe Cc te Avni Istrefi, Udhëheqës i këtij Divizioni në [avni.istrefi@rks-gov.net](mailto:avni.istrefi@rks-gov.net);
- Në mënyrë fizike në zyrën e Divizionit për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ) nr. 21 në katin e sipërm të ndërtesës së re të administratës së AKSP-së çdo ditë pune (përveç ditëve të festave zyrtare) nga ora 09:00 - 11:00 dhe nga 13:30 - 15:30.

Ky njoftim gjendet edhe në faqen e internetit të AKSP-së te pjesa e Fakultetit të Sigurië Publike te Shpalljet në linkun si në vijim: <https://aksp-ks.net/fsp/?page=1,31>.